



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr."Adem Jashari", pn, vvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel.028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 24. të Ligjit për Planifikim të Hapsirës nr. 2003/14, nenit 16 të Ligjit për ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e LPH mbi elementet e themelore të Planit Zhvillimor Urban, nr. rend. 34, prej 26.12/2003, nenit 17.pika b. c. d. k, l, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 38.1. (b,c,d.) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të pikës IV. dhe V. të Vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, nr.01-11735, dt. 30.10.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më date 24.09.2013 Shtator, 2013, miraton këtë:

V E N D I M

Për Ndririmin e Destinimit

Neni 1

Me këtë propozim Vendim miratohet ndrrimi i destinimit nga : *Gjelbrimi Publik* në destinim: * Ndërtim i Objektivit të kultit Fetar-Xhamisë* në parcelat kadastrale nr. 1443-02 dhe 1443-3, në sipërfaqe prej gjithësej = 976m², vendi i quajtur: "Zabeli i S. Agës" ZK-Gjilan, e evidentuar në emër të Alit (Rifat) Alitit nga Gjilani, në tërësi sipas paraqitjes grafike në kopje të planit dhe Ortofoto, të cilat janë pjesë përbërse e këtij vendimi.

Neni 2

Me ndrrimin e destinimit nga pika 1. e këtijë propozim vendimi krijohen kushtet dhe mundësit e caktimit të kushteve të ndërtimit sipas Ligjit të Ndërtimit.

Neni 3.

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, që ndrrimin e destinimit ta ta inkorporojë në Planin Rregullues Urban të lokacionit në fjalë.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjoedezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan

Neni 5.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej Plan Zhvillimor Urban i Qytetit të Gjilanit nr. nr.01-11735, dt. 30.10.2008, për ngastrën në fjalë.

01.Nr. 16-100742
Gjilan, më 24.09.2013.

Kuvendi I komunës,

Izmi Zeka, Kryesues